

V E N D I M
Nr. 542, datë 31.10.2002

**PËR MIRATIMIN E STATUTIT TË AGJENCISË SË NXITJES SË INVESTIMEVE TË
HUAJA (ANIH)**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 1 pika 2 e 9 të ligjit nr. 8877, datë 4.4.2002 "Për krijimin e Agjencisë së Nxitjes së Investimeve të Huaja", me propozimin e Ministrit të Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

Miratimin e statutit të Agjencisë së Nxitjes së Investimeve të Huaja (ANIH), që i bashkëlidhet këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano

Statuti i Agjencisë së nxitjes së investimeve të huaja (ANIH)

Dispozita të përgjithshme

Neni 1
Vlera ligjore e statutit

Statuti është dokumenti bazë, që rregullon veprimtarinë e kësaj agjencie, brenda dhe jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, krijimi i së cilës është parashikuar në ligjin nr. 8877, datë 4.4.2002 "Për krijimin e Agjencisë së Nxitjes së Investimeve të Huaja".

Neni 2
Statusi juridik i agjencisë

Agjencia është person juridik, publik, që nuk ushtron veprimtari fitimprurëse. Nëse ndonjë veprimtari e saj mund të gjenerojë të ardhura, ato duhet të kontabilizohen në zërat përkatëse të fondeve të agjencisë dhe të përdoren vetëm për qëllimin për të cilin është krijuar agjencia.

Neni 3
Emërtimi i shkurtuar

Emërtimi i shkurtuar i agjencisë është ANIH. Selia e saj ndodhet në Tiranë, në adresën Bulevardi "Zhan d'Ark", pallatet e Lanës.

Neni 4
Stema dhe vula

Stema e agjencisë shpreh thelbin e veprimtarisë së saj, që është tërheqja e investimeve të huaja dhe duhet të figurojë në të gjithë materialet prezantuese dhe shkresat zyrtare të agjencisë.

Përmbajtja e vulës së agjencisë është: "Republika e Shqipërisë, Agjencia e Nxitjes së Investimeve të Huaja (ANIH)".

Objekti i veprimtarisë së Agjencisë

Neni 5
Ligjshmëria e veprimtarisë

Agjencia vepron në mbështetje të dispozitave të Kodit Civil, përcakton mundësitë për investime, nxit dhe mbështet investitorët ekzistues dhe të rinj për të investuar në Shqipëri.

Neni 6
Objekti

Agjencia ka objekt të veprimtarisë:

- mbajtjen e lidhjeve me të gjitha ministrinë, agjencitë publike, institucionet financiare, dhomat e tregtisë, shoqatat e biznesit dhe të investitorëve dhe me organizata të tjera, të interesuara për të bashkërenduar veprimtaritë që u shërbejnë investitorëve;

- dhënien e ndihmës në zbatimin e politikave të qeverisë për investimet e huaja dhe të politikës së privatizimit;

- dhënien e rekomandimeve të nevojshme për përmirësimin e legjislacionit për të krijuar një klimë të favorshme për investitorët, sidomos ata të huaj;

- dhënien e këshillave investitorëve të huaj dhe lehtësimin e krijimit të lidhjeve të tyre me biznesin vendas, si në fazën fillestare e gjatë kryerjes së investimeve, edhe pas përfundimit të tyre. Gjithashtu, ajo ndihmon shoqëritë e huaja ekzistuese për kapërcimin e barrierave, që frenojnë zhvillimin e biznesit dhe ndihmon shoqëritë vendase për të gjetur partnerë të huaj, për të krijuar lidhje sa më të qëndrueshme me ta;

- mbledhjen, përpunimin, ndërtimin dhe zhvillimin e sistemit të të dhënave për investimet, si dhe shpërndarjen dhe shkëmbimin e këtyre të dhënave me rrjetin e subjekteve të interesuara, brenda dhe jashtë vendit;

- dhënien e ndihmesës në promovimin e kulturës së biznesit në të gjithë sektorët e ekonomisë së vendit;

- zhvillimin e veprimtarive nxitëse, brenda dhe jashtë vendit, për një imazh të Shqipërisë, si një vend tërheqës për investime dhe pasqyrimin e potencialeve në prodhimin e mallrave, shërbimeve, lëndëve të para me leverdi në konkurrencën e lirë;

- kryerjen e veprimtarive studimore, në përputhje me funksionet e saj, duke përfshirë studime fizibiliteti, studime tregu, anketime, konsulencë në praktikën tregtare të menaxhimit dhe të veprimtarive nxitëse.

Burimet e financimit

Neni 7
Burimet bazë të financimit

Në përputhje me nenin 8 të ligjit nr. 8877, datë 4.4.2002 "Për krijimin e Agjencisë së Nxitjes së Investimeve të Huaja", burimi kryesor i financimit të agjencisë vjen nga Buxheti i Shtetit.

Agjencia harton projektbuxhetin, sipas rregullave, metodikave dhe afateve të përcaktuara në ligjin nr.8379, datë 29.7.1998 "Për hartimin dhe zbatimin e Buxhetit të Shtetit të Republikës së Shqipërisë" dhe të akteve nënligjore në zbatim të tij.

Agjencia mund të sigurojë fonde shtesë edhe nga donatorë të ndryshëm.

Neni 8
Përdorimi i fondeve

Agjencia gëzon të drejtën e depozitimit dhe të përdorimit të mjeteve të veta financiare sipas vendimeve të Këshillit Mbikëqyrës.

Agjencia nuk mund të kryejë asnjë veprimtari tjetër jashtë objektivave dhe programit të përcaktuar në statut.

Fondet financiare nuk mund të përdoren, në mënyrë të drejtëpërdrejtë e as të tërthortë, për qëllime të tjera.

Burimet e ndryshme financiare agjencia i përdor vetëm për kryerjen e veprimtarive në

përputhje me objektin e vet.

Agjencia krijon dhe menaxhon fondet e mëposhtme:

- fondin themelor;
- fondin e mjeteve të xhiros;
- fondin rezervë, në lekë;
- fondin rezervë në valutë;
- fonde të tjera, sipas vendimeve të përcaktuara nga Këshilli Mbikëqyrës.

Neni 9

Qëndrimi ndaj donacioneve

Donacionet pranohen ose kundërshtohen me vendim të Këshillit Mbikëqyrës të Agjencisë, në përputhje me aktet, ligjore e nënligjore, në fuqi. Në rast kundërshtimi, në vendimin e Këshillit Mbikëqyrës të Agjencisë shënohen edhe arsyet e këtij kundërshtimi.

Donatorët e huaj ose vendas, që kontribuojnë me fonde financiare, me një vlerë më të madhe se 50 për qind e fondeve vjetore të Buxhetit të Shtetit për agjencinë kanë të drejtë të caktojnë një këshilltar pranë drejtorit ekzekutiv të agjencisë. Drejtori ekzekutiv është i detyruar të këshillohet me këshilltarin për të gjitha çështjet që kanë të bëjnë me përdorimin e fondeve të dhëna nga ai.

Struktura organizative e agjencisë

Neni 10

Organet drejtuese

Organet drejtuese janë:

1. Këshilli Mbikëqyrës,
2. drejtori ekzekutiv.

Këshilli mbikëqyrës

Neni 11

Përbërja

Përbërja e Këshillit Mbikëqyrës përcaktohet me vendim të Këshillit të Ministrave. Ministri i Ekonomisë është Kryetar i Këshillit Mbikëqyrës. Përfaqësuesit e komunitetit të biznesit propozohen nga shoqatat e biznesit dhe duhet të plotësojnë kriteret e përcaktuara në udhëzimin nr. 115, datë 6.8.2002 të Ministrit të Ekonomisë. Anëtarët e Këshillit Mbikëqyrës janë përfaqësues të komunitetit të biznesit dhe emërohen nga Ministri i Ekonomisë për një periudhë dyvjeçare me sistem rotacioni.

Kryetari i Këshillit Mbikëqyrës njofton Këshillin e Ministrave për problemet e rëndësishme lidhur me investimet e huaja.

Neni 12

Mandati i anëtarit të Këshillit Mbikëqyrës

Mandati i anëtarit të Këshillit Mbikëqyrës përfundon me:

- a) mbarimin e afatit të përcaktuar në nenin 11 të statutit, si dhe në rastet kur:
- b) jep dorëheqjen;
- c) shkarkohet nga detyra për veprime ose mosveprime, që dëmtojnë rëndë interesat e agjencisë;
- ç) mungon brenda 1 viti, pa arsye, në 4 mbledhje dhe me arsye në 6 mbledhje.

Kërkesa për dorëheqje i bëhet me shkrim Kryetarit të Këshillit Mbikëqyrës, i cili duhet ta miratojë atë brenda 5 (pesë) ditëve.

Neni 13

Detyrat e Këshillit Mbikëqyrës

Këshilli Mbikëqyrës ka këto detyra:

- Harton statutin e agjencisë dhe i propozon Këshillit të Ministrave ndryshime, kur e sheh të nevojshme.
- Miraton programin e veprimtarisë për vitin financiar, i cili paraqitet nga drejtori ekzekutiv.
- Miraton strukturën organizative dhe buxhetin.
- Miraton rregulloren e brendshme për funksionimin.
- Emëron dhe liron nga detyra drejtorin ekzekutiv.
- Miraton bilancin e veprimtarisë ekonomiko-financiare, në përputhje me legjislacionin në fuqi.
- Mbikëqyr, në vazhdimësi, përmbushjen e detyrave.

Neni 14

Mbledhja e Këshillit Mbikëqyrës

Këshilli Mbikëqyrës mbledhet periodikisht, jo më pak se 6 herë në vit, me thirrjen e kryetarit të Këshillit. Anëtarët lajmërohen, me shkrim, 15 ditë para zhvillimit të mbledhjes. Kur është e nevojshme, njoftimit i bashkëlidhen edhe projektvendimet që parashikohen të shqyrtohen në mbledhje.

Në raste të veçanta, mbledhja e Këshillit Mbikëqyrës thirret nga drejtori ekzekutiv ose nga të paktën tre anëtarë të Këshillit Mbikëqyrës.

Mbledhja drejtohet nga Kryetari i Këshillit Mbikëqyrës dhe, në mungesë të tij, nga anëtari më i moshuar.

Neni 15

Vlefshmëria e mbledhjeve

Këshilli Mbikëqyrës nuk mund të marrë vendime të vlefshme pa qenë të pranishëm gjysma e numrit të anëtarëve plus 1. Kur ky numër nuk arrihet mbledhja shtyhet edhe për 24 orë.

Vendimet merren me shumicë të thjeshtë votash të anëtarëve të pranishëm. Votimi është i hapur, përveç rasteve të veçanta të parashikuara me ligj. Votimi mund të kryhet edhe me anë të shkëmbimit të dokumentacionit të shkruar, sipas rregullave të konsultimit me shkrim. Në rast rezultati të barabartë votash, vota e kryetarit është përcaktuese.

Neni 16

Pjesëmarrja në mbledhje e personave të tjerë

Në mbledhjet e Këshillit Mbikëqyrës kryetari fton këshilltarë ose dhe ekspertë të jashtëm, kur këtë e kërkojnë rrethanat.

Drejtori ekzekutiv, këshilltarët dhe ekspertët e ftuar marrin pjesë në mbledhje pa të drejtë vote.

Neni 17

Konflikti i interesave

Anëtarët e Këshillit Mbikëqyrës detyrohen të deklarojnë pozicionin e tyre në Këshillin Mbikëqyrës, kur çështje të rendit të ditës dhe vendime të Këshillit Mbikëqyrës lidhen drejtpërdrejt me interesat e tyre të biznesit. Në këto raste, ata nuk marrin pjesë në diskutime dhe as në votim.

Neni 18

Shpërblimi

Anëtarët e Këshillit Mbikëqyrës gëzojnë të drejtën e shpërblimit për pjesëmarrje në mbledhjet e Këshillit, sipas vendimit nr. 334, datë 11.7.2002 të Këshillit të Ministrave dhe të rimbursimit të shpenzimeve për shërbime, udhëtime e dieta, që lidhen me veprimtarinë e tyre për zbatimin e programit të agjencisë.

DREJTORI EKZEKUTIV I AGJENCISË

Neni 19

Mandanti i drejtorit ekzekutiv

Drejtori ekzekutiv emërohet nga Këshilli Mbikëqyrës, në mbledhjen e parë të tij për një afat trevjeçar, me të drejtë rizgjedhjeje edhe për tre vjet të tjera. Zgjedhja e tij bëhet me konkurs, ku të paktën të jenë tre konkurrues. Data e konkursit botohet në organet e shtypit.

Neni 20

E drejta e përfaqësimit

Agjencia, në marrëdhënie me të tretët, përfaqësohet nga drejtori ekzekutiv dhe, në mungesë të tij, nga zëvendësdrejtori. Zëvendësdrejtori emërohet nga drejtori ekzekutiv, për një mandat trevjeçar.

Neni 21

Të drejtat dhe detyrat e drejtorit ekzekutiv

Drejtori ekzekutiv ka këto të drejta dhe detyra:

- Drejton dhe administron veprimtarinë e agjencisë dhe përgjigjet para Këshillit Mbikëqyrës.
- Harton rregulloren e brendshme të agjencisë dhe ia paraqet për miratim Këshillit Mbikëqyrës.
- Në funksion të përmbushjes së programit të punës, i paraqet Këshillit Mbikëqyrës, para fillimit të një veprimtarie, buxhetin dhe programin e realizimit të saj.
- Harton dhe i paraqet për miratim Këshillit Mbikëqyrës bilancin e agjencisë.
- Përgjigjet për shpenzimet e bëra nga buxheti, në përputhje me objektivat, qëllimin e funksionimit të agjencisë.
- Raporton të paktën 4 herë në vit para Këshillit Mbikëqyrës për veprimtarinë e agjencisë.
- Harton dhe zbaton procedurat e punësimit të personelit, me metodën e konkurrit, të shpallur publikisht, për çdo vend pune.
- Bashkërendon punën me Këshillin Mbikëqyrës për të zhvilluar dhe administruar strategjinë e qeverisë për nxitjen e investimeve.
- Përgjigjet për të gjitha veprimtaritë e agjencisë që i shërbejnë përmirësimit të imazhit të Shqipërisë.
- Bashkëpunon me donatorë, vendas dhe të huaj, për sigurimin e fondeve.
- Krijon, zhvillon dhe ruan lidhje të vazhdueshme institucionale me përfaqësues të organizatave të biznesit dhe të institucioneve publike.
- Garanton cilësinë e materialeve, informuese e promovuese dhe shpërndarjen e tyre në kohë.

Neni 22

Mbarimi i mandatit

Drejtori ekzekutiv lirohet nga detyra në rastet kur:

- a) i mbaron mandati dhe nuk riemërohet;
- b) mbush moshën e pensionit;
- c) emërohet në një detyrë tjetër, të papajtueshme me atë të drejtorit ekzekutiv.

Drejtori ekzekutiv lirohet nga detyra edhe para mbarimit të mandatit kur:

- a) vërehet se agjencia mbingarkohet me borxhe për shkak të drejtimit të tij;
- b) shpallet fajtor me vendim të gjykatës së formës së prerë për kryerjen e një vepre penale;
- c) vepron në kundërshtim me programin dhe objektivat e miratuara nga Këshilli Mbikëqyrës.

Zëvendësdrejtori shkarkohet nga detyra me urdhër të drejtorit ekzekutiv, por pas miratimit nga kryetari i Këshillit Mbikëqyrës.

Marrëdhëniet e punës

Neni 23

Struktura e organika e agjencisë dhe pagat

Struktura e organika e agjencisë dhe niveli i pagave përcaktohen e miratohen me vendim të Këshillit Mbikëqyrës, në përputhje me nivelin e pagave në institucionet e administratës qendrore.

Neni 24

Rregullat e punësimit

Kriteret e marrjes në punë dhe përshkrimi i vendeve të punës përcaktohen nga Këshilli Mbikëqyrës. Lidhja e kontratave të punës bëhet nga drejtori ekzekutiv.

Neni 25

Viti financiar

Viti financiar i agjencisë fillon më 1 janar dhe mbaron më 31 dhjetor të atij viti. Për çdo vit financiar hartohet bilanci ekonomiko-financiar, konform dispozitave ligjore në fuqi. Brenda datës 30 prill të çdo viti, drejtori ekzekutiv i paraqet Këshillit Mbikëqyrës, për shqyrtim e miratim, bilancin e vitit financiar pararendës.

Neni 26

Kontrolli

Këshilli Mbikëqyrës cakton ekspertë ose ekspertë kontabël, të autorizuar sipas ligjeve në fuqi për ushtrimin e kontrollit të veprimtarisë ekonomiko-financiare të agjencisë.

Neni 27

Dispozita të fundit

Çështje të veçanta të veprimtarisë së agjencisë, që nuk parashikohen në këtë statut, do të përfshihen në rregulloren e brendshme të agjencisë.

Neni 28

Hyrja në fuqi

Ky statut hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.